



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, BUXHETIT DHE KOMUNIKIMIT

**SHPLLJE PËR NJË VEND TË LIRE PUNE,  
LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË DHE PRANIM NGA  
JASHTË SHËRBIMIT CIVIL**

**“Inspektor” në Drejtorinë Juridike, Integritit dhe Çështjeve  
Gjyqësore  
Kategoria e pagës III-a**

Në zbatim të nenit 25 dhe 26, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, ndryshuar me të fundit nr. 748, datë 19.12.2018, Autoriteti i Konkurrencës shpall procedurat e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranim nga jashtë shërbimit civil për pozicionin:

- “Inspektor” në Drejtorinë Juridike, Integritit dhe Çështjeve Gjyqësore
- Kategoria e pagës III-a

**Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!**

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

**Për procedurat (lëvizje paralele, ngritje në detyrë dhe pranim nga jashtë shërbimit civil ) aplikohet në të njëjtën kohë!**

**Afati për dorëzimin e dokumenteve:**

**1 qershor 2022**

**\*Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit është i njëjtë për të gjitha procedurat.**

## **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin e mësipërm është:**

---

Inspektori përgjigjet për ndjekjen dhe zbatimin e PKIE-së dhe procesit të integritetit përse i përket Autoritet të Konkurrencës, i cili është lider dhe koordinues i Kapitullit 8 “Politika e Konkurrencës” në procesin e integritetit evropian. Gjithashtu është përgjegjës për promovimin prezantimin e AK-së, shkëmbimin e eksperiencave me profesionalizëm, dhe shfrytëzimin e praktikave më të mira evropiane. Ndjek eurinë e procesit të integritetit evropian duke bashkëpunuar dhe raportuar rregullisht sipas kërkesave me MIE dhe mban korrespondencën institucionale të marrëdhënieve me jashtë. Përgatit raportet për organizmat ndërkombëtar, bashkërendon punën për sigurimin e mbarëvajtjes së të gjithë aktiviteteve ndërkombëtare të realizuara brenda e jashtë vendit, në kuadër strategjish, plane pune, etj.

## **I-Lëvizja paralele**

---

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

### **1.- Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta**

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (kategoria III-a),
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë të paktën një vlerësim pozitiv (për kandidatët e institucioneve që sapo kanë hyrë në shërbimin civil kërkohet vlerësim nga eprori direkt);

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të arsimit të lartë të nivelit “Master shkencor”, në fushën e shkencave juridike,
- b) Të zotërojnë njohuri shumë të mira profesionale në këtë fushë,
- c) Avantazh do të përbëjnë dhe studime apo diploma të tjera pasuniversitare në këtë fushë,
- d) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet në nivel të ulët drejtues,
- e) Të zotërojnë gjuhën angleze dhe çdo gjuhë e dytë e vendeve të BE përbën avantazh.

### **2.- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë përgjegjëse të burimeve njerëzore të Autoritetit të Konkurrencës ku ndodhet pozicioni për të cilin ata dëshirojnë të aplikojnë, dokumentet si më poshtë:

a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

b) fotokopje të diplomës;

c) fotokopje të librezës;

d) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

***Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 1 qershor 2022***

### **3.- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak**

Në datën **2 qershor 2022** njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore të Autoritetit të Konkurrencës ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e internetit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

### **4.- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar,
- b) Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike,
- c) Konkurrimi do të bazohet dhe në njohjen e ligjshmërisë në fuqi, kryesisht ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, dhe akteve nën ligjore në zbatim të tij, Politika Kombëtare e Konkurrencës, Kodin e Procedurave Administrative,
- d) *Për më shumë: [www.caa.gov.al](http://www.caa.gov.al)*

### **5.- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve**

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;

- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015 të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta>

## **6.- Data e daljes së rezultateve të konkurrimit dhe mënyra e komunikimit**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Autoriteti i Konkurrencës do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të AK. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

## **II- Ngritja në detyrë**

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

*Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme në përputhje me nenin 26 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësit civil”, i ndryshuar.*

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë

### **Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- Të zotërojë diplomë të arsimit të lartë të nivelit “Master shkencor” në fushën e shkencave juridike,
- Të zotërojë njohuri shumë të mira profesionale në këtë fushë,
- Avantazh do të përbëjnë dhe studime apo diploma të tjera pasuniversitare në këtë fushë,
- Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet në nivel ekzekutiv,
- Të zotërojë gjuhën angleze dhe çdo gjuhë e dytë e vendeve të BE përbën avantazh.

**Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:**

a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

b) fotokopje të diplomës dhe listës së notave;

c) fotokopje të librezës së punës;

d) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

e) Vërtetimi i gjendjes gjyqësore

f) Numër kontakti dhe adresë vendbanimi

Kandidatët duhet të dorëzojnë të gjitha dokumentet e cituara më sipër me poste ose dorazi, *brenda datës 1 qershor 2022* në Autoritetin e Konkurrencës me adresë: Rruga “Sami Frashëri”, kati IV. Nr.4.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë do të marrin informacion në faqen e Autoritetit të Konkurrencës për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Autoritetit të Konkurrencës duke filluar nga data **2 qershor 2022**.

Në rast se një vend vakant në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese, nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe Këshilli i Ministrave për institucionet e administratës shtetërore apo organi kompetent për institucionet e pavarura ka marrë vendim në përputhje me pikën 4, të nenit 26 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, atëherë në procedurën e ngritjes në detyrë kanë të drejtë të konkurrojnë edhe kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil.

Tiranë, më 17.05.2022